



FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Përgjithshme

Nr. 5689 Prot.

Tiranë, më 06.12.2018

UDHËZIM

Nr. 13, datë 06.12.2018

**“PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT PËR MIRATIMIN E LIDHJES
SË KONTRATAVE ME FARMACITË DHE AGJENCITË FARMACEUTIKE PËR HERË
TË PARË ME FONDIN”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 1, shkronja “r”, të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të Vendimit Nr.71, datë 22.12.2015, të Këshillit Administrativ të Fondit, “Për kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratës me Fondin dhe procedurat për lidhjen e kontratës”, të ndryshuar dhe të Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit Nr. 5, datë 04.05.2018, “Për lidhjen e kontratave me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për vitin 2018”,

UDHËZOJ:

1. Trajtimi i kërkesave të subjekteve që kërkojnë të lidhin kontratë për herë të parë me Fondin, bëhet nga Komisioni për lidhjen e kontratës për herë të parë me Fondin, i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit.
2. Me marrjen e kërkesës për lidhjen e kontratës për herë të parë nga subjekti, komisioni kërkon në mënyrë zyrtare nga Drejtoritë Rajonale të Fondit, informacion mbi historikun e subjektit farmaceutik në marrëdhëniet kontraktuale me Fondin, duke përfshirë personin fizik/ortakun e vetëm/administratorin/përfaqësuesin ligjor, drejtuesin teknik, mbi vendndodhjen e subjektit aplikues dhe nëse ka subjekte të tjerë të kontraktuar me DRF në atë zonë, afërsinë me institucionet shëndetësore si dhe informacione të tjera që i vlerëson të nevojshme.

3. Komisioni verifikon:

- a) Formularin tip të Vetëdeklarimit, (shkarkohet në www.fsdksh.com.al). Të dhënat duhet të përputhen me ato të deklaruara në QKB;
- b) Kopje të licencës së ushtrimit të aktivitetit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit-QKB;
- c) Kopje të certifikatës së regjistrimit tatimor, NIPT/NUIS, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit-QKB;
- d) Genplanin/Planimetrinë e mjedisit mbi 50 m² (15 m² agjencia), lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar;
- e) Plan vendosjen lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar, ku:

- distanca/largësia e farmacisë/agjencisë të jetë mbi 150 metra (rrugë këmbësore) nga farmacitë/agjencitë ekzistuese me kontratë,
- distanca/largësia e farmacisë të jetë mbi 20 metra nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor Publik (*nuk aplikohet për agjencitë farmaceutike*).

4. Genplani/Planimetria të jetë në shkallën 1: 100. Plan vendosja të jetë në shkallën 1: 500. Planvendosja të paraqesë të gjitha objektet rrethuese në një rreze prej 200 metra nga kufijtë e objektit farmaci të subjektit kërkues. Në planvendosje të emërtohen objektet si farmaci me kontratë, farmaci pa kontratë, qendër shëndetësore, spitale, konsultore etj. Nëse dokumentacioni nuk plotëson kërkesat e mësipërme do t'i kthehet subjektit për plotësim.

5. Komisioni verifikon dokumentacionin për përmbushjen e kritereve të mësipërme. Kryetari i komisionit cakton tre nga anëtarët e tij, rast pas rasti, për të kryer verifikimet në terren, kur:

- Të dhënat e distancës dhe largësisë janë shumë afër vlerave të kërkuara;
- Kur ka të dhëna kontradiktore mes dokumentacionit të paraqitur dhe konfirmimeve të Drejtorisë Rajonale të Fondit;
- Kur ka ankesa nga subjektet e tjera për subjektin që ka aplikuar.

6. Grupi që bën verifikimin në terren do të paraqesi pranë komisionit aktin e verifikimit të mbajtur pranë subjektit dhe relacionin përkatës.

7. Komisioni bazuar në tërësinë e dokumentacionit të mbledhur si më sipër, merr vendim për miratimin ose jo të kërkesës dhe vazhdimin e procedurës për lidhjen e kontratës nga DRF-ja përkatëse.

8. Mbi bazën e vendimit të komisionit, Fondi njofton subjektin aplikues dhe Drejtorinë Rajonale, mbi vazhdimin ose jo të procedurës së lidhjes së kontratës.

9. Në rast të miratimit për vazhdimin e procedurës, Drejtorinë Rajonale duhet të informojnë Fondin për lidhjen e kontratës brenda 14 ditëve (ditë pune).

10. Ngarkohen anëtarët e komisionit për miratimin e lidhjes së kontratave me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike që lidhin kontratë për herë të parë me Fondin dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit, për zbatimin e këtij udhëzimi.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Anila Denaj

